



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura V**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 30  
Prishtinë, më 22 qershor 2016, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-303-

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCAVE PUBLIKE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Faton Topalli, Synavere Rysha, Ali Sadriu, Naim Fetahu, Hajdar Beqa dhe Abdyl Ymeri.

**Munguan:** Bali Muharremaj, Fikrim Damka dhe Enver Hoti.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ- i.

**Pjesëmarrësit e tjerë në takim:** Kosum Aliu dhe Kimete Arifi, nga Ministria e Financave, Ilir Abazi, nga ZKA dhe Agnesa Haxhiu, KDI.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 15.6.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor për funksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike të Republikës së Kosovës për vitin 2015;
4. Ecuria në realizimin e planit vjetor të punës së KMFP-së;
5. Të Ndryshme.

**Kryetari**, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryetari** konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.6.2016**

*Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 15.6.2016, pa vërejtje.*

## **3. Shqyrtimi i Raportit vjetor për funksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike të Republikës së Kosovës për vitin 2015**

**Faton Topalli, kryetar,** theksoi se në këtë pikë kemi të bëjmë me shqyrtimin e raportit vjetor të Qeverisë për funksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike, ku të fuar kemi drejtorin e NJQHAB-së, bashkë me stafin e njësisë, me këtë hapi diskutimin.

**Kosum Aliu,** drejtor i NJQHAB-së, theksoi se Njësia Qendrore Harmonizuese, në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenin 6, paragrafi 6.2, pika (h) të plotësim-ndryshimit të Ligjit nr. 04/L-194, si dhe të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-128 për auditim të brendshëm, ka përgatitur raportin vjetor për funksionimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP), për vitin 2015.

Raporti paraqet të arriturat, gjetjet dhe masat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e sistemit të kontrollit të financave publike. Të dhënat kryesore janë siguruar nga pyetësorët e vetëvlerësimit, të pranuar nga organizatat buxhetore, raportet vjetore të pranuar nga njësitë e auditimit të brendshëm, planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm, monitorimi i NJAB-së, raportet e auditorit të përgjithshëm, Raporti i Progresit, raporti i SIGMA-as, intervistave dhe informatave të mbledhura nga trajnimet dhe seminarët e ndryshme.

Sa i përket strategjisë për auditim të brendshëm, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar raportin më 15 prill 2015. Po ashtu, është përgatitur moduli për auditim të brendshëm, i cili ka të bëjë me certifikimin e auditorëve të brendshëm, si dhe të punësuarve në sektorin publik, për ata që kanë shprehur interesim. Po ashtu, plotësimi i formularëve të vetëvlerësimit. Nga 108 organizata buxhetore, të cilave u janë shpërndarë pyetësorët e vetëvlerësimit, 95 prej tyre kanë plotësuar pyetësorët. Kjo përbën një rritje prej 6.7% të organizatave që kanë plotësuar pyetësorët e vetëvlerësimit (prej 89 në 95), krahasuar me vitin e kaluar. Është shënuar përmirësim në cilësinë e informatave të raportuara përmes pyetësorëve të vetëvlerësimit, të përgatitur nga zyrtarët kryesorë administrativë dhe zyrtarët financiarë. Kjo është arritur përmes trajnimeve, zhvillimin e pilot-projekteve për zbatimin e MFK-së dhe trajnimi për plotësimin e pyetësorëve të vetëvlerësimit në formë online. Sa i përket auditimit të brendshëm, 95.77% (68 -71) e njësive të auditimit të brendshëm kanë raportuar për aktivitetet e auditimit të brendshëm të zhvilluara në organizatat e tyre buxhetore, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal. Nëse krahasojmë vitin 2014 me 2015, kemi një rritje prej 1.5% (67- 68). Njësitë e auditimit të brendshëm, gjatë vitit 2015, kanë kryer 489 auditime të brendshme, që krahasuar me planin, kemi një realizim për 102%. Përkundër që në dukje kemi një rritje të realizimit të planit, kjo nuk do të thotë që të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm e kanë realizuar planin e tyre. Rritja e auditimeve të kryera, krahasuar me auditimet e planifikuara, ka rrjedhur si pasojë e 40 auditimeve të kryera me kërkesë të menaxhmentit. Nëse krahasojmë vitin 2014 me 2015, kemi një rritje të numrit të auditimeve të kryera për 0.41% (487- 489). Njësitë e auditimit të brendshëm kanë arritur t'i realizojnë 489 auditime, megjithatë kjo nuk nënkupton se të gjitha njësitë e auditimit kanë realizuar planin e

tyre. 40 auditime janë bërë me kërkesë të menaxhmentit. Nëse krahasojmë vitin 2014 me 2015, kemi një rritje të implementimit të rekomandimeve, prej 4.74% (49.24% në 53,98%).

Për çdo vit, NJQHAB-ja mban një konferencë të përbashkët, me të interesuar, lidhur me të arriturat dhe sfidat e kontrollit të brendshëm. Sfidë mbetet menaxhimi i rrezikut, ku shumica e OB-ve nuk kanë lista të rrezikut. MF ka një marrëveshje me Ambasadën e Luksemburgut për të na mbështetur në këtë drejtim. Po ashtu, është kërkesë e jona që Kuvendi ta ketë një njësi të përbashkët të auditimit të brendshëm, për t'i audituar agjencitë e pavarura, që nuk kanë auditorë të brendshëm.

**Ilir Abazi**, ky është një raport i përgatitur nga NJQHAB, është raport i mirë dhe gjithëpërfshirës. Ne si ZAP, kemi analizuar raportet individuale të auditorëve të brendshëm, dhe si të tilla, janë pasqyruar në raportet tona të ZKA-së.

**Abdyl Ymeri**, theksoi se bazuar në raport, thuhet se 95% e OB-ve kanë plotësuar formularin e vetëvlerësimit, megjithatë një pjesë prej 5% nuk i kanë plotësuar formularët. Cila është arsyeja e mosplotësimit të formularëve? Obligimin për raportim në NJQHAB e kanë realizuar 68 njësi të auditimit të brendshëm, kundrejt 71 sa janë të krijuara ose shprehur në përqindje, 95.77% e njërive.

Nëse krahasojmë vitin 2014 me 2015, kemi një rritje të implementimit të rekomandimeve prej 4.74% (49.24% në 53,98%). Megjithatë, prapë kemi ngecje në këtë drejtim. Menaxhimi i rrezikut konceptohet si tërësia e proceseve të përfshira në identifikimin, vlerësimin dhe gjykimin e rreziqeve, përcaktimin e përgjegjësisë, ndërmarrjen e veprimeve për zvogëlimin apo parashikimin e tyre, si dhe monitorimin dhe rishikimin e progresit. Kjo tregon se auditorët e brendshëm nuk kanë vlerësuar mirë rrezikun.

**Ali Sadriu**, theksoi se raporti vjetor i Qeverisë, lidhur me funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik për vitin 2015, është miratuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës, më datë 20 maj 2016. I njëjti është dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më datë 31.5.2016.

Në bazë të nenit 6, paragrafi 6.2, pika (h) të LMFPP dhe në bazë të nenit 8, pika 1.2 të Ligjit për auditimin e brendshëm, drejtori i NJQHAB-së duhet të përgatisë dhe të dorëzojë në Ministri raportin vjetor formal, me shkrim, për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm, i cili raport, pastaj së bashku me komentet e ministrit procedohet në Qeveri, Kuvend dhe në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti paraqet të arriturat, gjetjet, sfidat dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e sistemit të kontrollit të financave publike.

Nga 108 organizata buxhetore, të cilat kanë pranuar formularët e vetëvlerësimit, 95 prej tyre kanë plotësuar pyetëtorët apo shprehur në përqindje 87.9% e tyre. Po ashtu, është vërejtur se ka përmirësim në cilësinë e plotësimit të formularëve (kjo është arritur përmes trajnimeve të organizuar nga NJQHAB-ja). Sa i përket aktiviteteve të auditimit të brendshëm, 95.77% e njërive të auditimit kanë raportuar për aktivitetet e auditimit të brendshëm.

Njësitë e auditimit të brendshëm kanë arritur t'i realizojnë 489 auditime. Megjithatë, kjo nuk nënkupton se të gjitha njësitë e auditimit kanë realizuar planin e tyre. 40 auditime janë bërë me kërkesë të menaxhmentit. Gjatë vitit 2015, 53 (pesëdhjetë e tre) komitete të auditimit e kanë ushtruar funksionin e tyre, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal. Megjithatë, me komitete të auditimit janë mbuluar 58 subjekte të Sektorit Publik ose 81.69%. Nëse krahasojmë vitin 2014 me 2015, kemi një rritje të implementimit të rekomandimeve, prej 4.74% (49.24% në

53,98%). Mendoj se raporti si i tillë është gjithëpërfshirës dhe se në fushën e auditimit të brendshëm, aktualisht, është bërë progres, krahasuar me vitin e kaluar.

**Synavere Rysha**, theksoi se raporti vjetor i Qeverisë, lidhur me funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik për vitin 2015, është shumë i detajuar, duke paraqitur sfidat dhe të arriturat në fushën e auditimit të brendshëm. Në 71 njësi të auditimit të brendshëm, janë të angazhuar 147 auditorë të brendshëm. Prej tyre, në nivelin qendror 93 auditorë të brendshëm, kurse në atë lokal 54. Gjatë vitit 2015, kemi një ulje të numrit të auditorëve të brendshëm në nivelin lokal. Gjatë vitit 2016, Komuna e Lipjanit, dy auditorë të brendshëm i ka sistemuar në pozita tjera, brenda komunës dhe një auditor të brendshëm nga Komuna e Deçanit është sistemuar në pozitë tjetër, brenda komunës. Zbatimi i rekomandimeve është sfidë, megjithatë, kjo është pengesë edhe në nivelin e raporteve të auditimit të jashtëm. Nëse krahasojmë vitin 2014 me 2015, kemi një rritje të implementimit të rekomandimeve, prej 4.74% (49.24% në 53,98%). Në bazë të informatave të pranuar nga raportet e NJAB-ve për vitin 2015, në nivelin qendror dhe lokal janë kryer gjithsej 489, kundrejt 481 auditimeve të planifikuara. Në analizën që është bërë, është vërejtur mosrealizim i planit nga ato të planifikuara për 36 auditime ose shprehur në përqindje, për 7.54%, si dhe rritje e numrit të auditimeve, me kërkesë të menaxhmentit, për 40 auditime ose shprehur në përqindje për 8.32%. Mendoj se raporti i Njesisë është shumë përmbajtësor dhe si i tillë duhet të miratohet në Komision.

**Naim Fetahu**, tha se në raport është thënë se menaxhmenti ende nuk e ka kuptuar rëndësinë e kontrollit të brendshëm. Unë pyes se për cilin nivel të menaxhmentit bëhet fjalë? Po ashtu, në raport thuhet se gjatë vitit 2015, obligimin për dorëzimin e planit strategjik dhe vjetor tek NJQH-ja e kanë realizuar 67 NJAB ose shprehur në përqindje 94.37%. Pse OB-të tjera nuk e kanë dorëzuar? Obligimin për raportim në NJQHAB e kanë realizuar 68 njësi të auditimit të brendshëm, kundrejt 71 sa janë të krijuara ose shprehur në përqindje 95.77 e njëjësive. Nëse krahasojmë vitin 2014 me vitin 2015, kemi një rritje prej 1.5% (67- 68). Ndërsa, në faqen 25 thuhet se planin nuk e kanë realizuar 68 NJAB. Cila është e vërteta në këtë? Po ashtu, problem më vete paraqet menaxhimi i rrezikut nga ana e NJQHAB-së dhe NJAB-së në OB. Sa i përket auditimeve të përbashkëta, se a po preket pavarësia e funksionimit të pavarur të institucioneve, rast të tillë kemi tek Dogana dhe ATK-ja, që janë të paraqitura edhe në raport.

**Faton Topalli, kryetar**, shtoi se raporti i NJQHAB-së është bazuar në formularët e vetëvlerësimit, të plotësuar nga ana e OB-ve. Sipas të dhënave të paraqitura në këtë raport, vërehet se ka shumë punë për të bërë në fushën e auditimit të brendshëm. Bazuar në të dhënat e paraqitura në këtë raport, vërehet se një numër i konsideruar i organizatave nuk kanë plotësuar formularët e vetëvlerësimit. Po ashtu, disa organizata buxhetore nuk kanë funksionalizuar njësitë e auditimit të brendshëm, si dhe komitetet e auditimit. Një pjesë e konsideruar e organizatave buxhetore nuk kanë auditorë të brendshëm, si dhe në ato organizata buxhetore që kanë auditorë të brendshëm, rekomandimet e tyre nuk po gjejnë zbatim, për shkak të mospërkrahjes së duhur nga menaxhmenti. Andaj, ne si KMFP, duhet të vendosim që këtë raport ta adresojmë për në seancë plenare, së bashku me rekomandimet e përgatitura nga stafi mbështetës i KMFP-së. Rekomandimet janë të përgatitura për t'u adresuar për NJQHAB-në, si dhe për Qeverinë. Rekomandimet janë si vijon:

1. Njësia Qendrore Harmonizuese e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), në afatin kohor sa më të shkurtër, të hartojë planin e veprimit për adresimin e dobësive të vlerësuara në

Raportin vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik, në veçanti, për këto rekomandime:

- a) Me qëllim që auditimi i brendshëm nëpër organizata buxhetore të jetë më efektiv, NJQHAB duhet të bëjë monitorimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm dhe të kërkojë që, NJAB-të nëpër OB, të bëjnë një planifikim të arsyeshëm të aktiviteteve vjetore, ku përfshihet numër më i madh i auditimeve.
  - b) Me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit në mes të auditimit të brendshëm dhe menaxhmentit, NJQHAB të planifikojë tryeza diskutimi, nëse është nevoja edhe trajnime për menaxhmentin, në mënyrë që të kuptohet drejt funksioni dhe roli i auditimit të brendshëm.
  - c) Me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale për stafin e auditimit të brendshëm, KMFP rekomandon NJQH-në, që të vazhdojë me trajnimin dhe licencimin e auditorëve të brendshëm në Sektorin Publik.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës, në afatin sa më të shkurtër kohor, të hartojë planin e veprimit për adresimin e dobësive të vlerësuara në Raportin vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike në Sektorin Publik, në veçanti:
- a) Të themelohen NJAB-të, aty ku ka mundësi ligjore dhe buxhetore, ndërsa aty ku njëra nga këto mundësi mungon, atëherë këto shërbime të merren nga OB-të tjera, siç kanë bërë disa OB edhe gjatë vitit 2015.
  - b) Me qëllim të ngritjes së pavarësisë së auditimit të brendshëm nëpër OB, të formohen komitetet e auditimit ose këto funksione të merren si shërbime nga ndonjë OB tjetër.
  - c) Qeveria duhet të obligojë çdo organizatë buxhetore, që të plotësojë formularin e vetëvlerësimit në mënyrë profesionale dhe objektive, në mënyrë që të pasqyrohet një gjendje e vërtetë e sistemit të kontrollit të brendshëm në OB dhe njëkohësisht kjo të vërtetohet nga NJAB, gjatë vitit.
  - d) Qeveria duhet të obligojë të gjitha OB-të, që të implementojmë të gjitha rekomandimet e auditimit të brendshëm.

Kryetari i hodhi në votim këto rekomandime, së bashku me Raportin vjetor të Qeverisë lidhur me funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik, për vitin 2015.

#### *Përfundim*

*Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi dhe vendosi ta adresojë për Seancë plenare, Raportin vjetor të Qeverisë, lidhur me funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në Sektorin Publik për vitin 2015, së bashku me rekomandimet për NJQHAB-në, si dhe për Qeverinë.*

#### **4. Ecuria në realizimin e planit vjetor të punës së KMFP-së**

**Faton Topalli, kryetar,** theksoi se në këtë pikë do të diskutohet plani i punës së KMFP-së, bashkë me planin financiar. Arsyeja pse kem vendosur për këtë pikë të rendit të ditës, është se në mbledhjen e kaluar të KMFP-së, është kërkuar që të rishikohet buxheti i Komisionit për pikën që ka të bëjë me angazhimin e ekspertëve. Pra, është kërkesë e deputetëve të KMFP-së, që kjo pikë e rendit të ditës të trajtohet në mbledhjen e radhës së KMFP-së.

#### *Përfundim*

*Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, vendosi që pika për realizimin e planit vjetor të punës, bashkë me planin e buxhetit për vitin 2015, të diskutohet në mbledhjen e radhës së KMFP-së.*

#### **5. Të ndryshme**

**Faton Topalli, kryetar,** njoftoi deputetët dhe të pranishmit tjerë në këtë takim për numrin e raporteve të auditimit të jashtëm, të dorëzuara deri tani në KMFP. Pasi paraqiti edhe opinionet e dala nga këto raporte, së bashku me deputetët e tjerë, vendosën që për mbledhjen e radhës së Komisionit, të diskutohet edhe për raportet e auditimit të jashtëm.

#### *Përfundim*

*Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, vendosi që në mbledhje e radhës së Komisionit, të diskutohet raporti i auditimit për menaxhimin e procesit të pajisjes së nxënësve me tekste shkollore, si dhe raporti i auditimit për PVF për Zyrën e Rregullatorit të Ujit dhe Kanalizimeve, për vitin 2015.*

Takimi përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

---

Faton Topalli